



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
"PORTI DETAR" Vlorë sh.a.
DREJTORI

Nr. 421 Prot.

Vlorë, më 15.07.2016

MIRATOHET
DREJTORI
TED NASTO

KODI I ETIKËS
Në "Porti Detar" Vlorë sh.a.



Neni 1
Qëllimi

Kodi i Etikës ka për qëllim të vendosë rregulla të sjelljes për të gjithë punonjësit e "Porti Detar" Vlorë sh.a. në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të standardeve të kërkuara për gjithë punonjësit e administrates dhe sektorëve të tjerë, t'i ndihmoje ata për arritjen e këtyre standardeve dhe të vere ne dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë secili prej tyre në kryerjen e punës dhe realizimin e detyrave sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës, Rregulloren e Brendshme të "Porti Detar" Vlorë sh.a. etj.

Neni 2
Fusha e veprimit

Kodi i Etikës është i detyrueshëm për zbatim për të gjithë punonjësit e "Porti Detar" Vlorë sh.a. duke përfshirë nga punonjësit më të thjeshtë në degët përkatëse e deri te kryetarët/shefat e degëve/sektorëve përkatës si dhe administratori dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre në ambjentet e punës ku ata punojnë.

Neni 3
Parime të përgjithshme dhe detyrime të punonjësve

Punonjësit e "Porti Detar" Vlorë sh.a. gjatë kryerjes së detyrës duhet të udhëhiqen nga parimi i përpikmërisë, korrektësisë, ndershmërisë, mirësjelljes, vullnetit të mirë, bashkëpunimit dhe solidaritetit.

Punonjësit e "Porti Detar" Vlorë sh.a. duhet që :

- a- Të respektojë dhe kryejë detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe kontratës kolektive të firmosur midis punëdhënësit dhe



- punëmarrësit.
- b-** Të ruajë një paraqitje dhe sjellje serioze përpara kolegëve të punës, eprorëve dhe/apo vartësve si dhe gjithë personave të tjerë, gjatë orarit të punës, që përfshin veshje serioze e dinjitoze, përdorimin e një fjalori të zgjedhur dhe brenda normave të etikës e të sjelljes qytetare.
 - c-** Të zbatojë me korrektësi detyrën dhe urdhërat e eprorit/ëve në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë.
 - d-** Të shfaqë sjellje të mirë brenda normave të etikës qytetare e profesionale në marrëdhënie me qytetarët që u shërben dhe me eproret, koleget dhe/apo vartësit e tij.
 - e-** Të përdorë kohën e punës në mënyrë efektive për realizimin e detyrave të tij funksionale. Kjo kohe nuk përdoret për asnjë qellim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar zyrtarisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - f-** Të shmangë rastet kur ka konflikt interesash sipas legjislacionit në fuqi, duke i deklaruar ato përpara eprorit, sapo të jenë shfaqur.
 - g-** Të mos lejojë që marrëdhëniet personale të prekin dhe të mos krijojnë përshtypjen se prekin marrëdhëniet me personat e tjerë.
 - h-** Të mos lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij në punë, të shmangë konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat, të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje apo favorizime në veprimtarinë dhe vendin e tij të punës.
 - i-** Të mos veprojë arbitrarisht në dem të interesave të shoqërisë, kolegëve, qytetarëve apo personave të tretë.
 - j-** Të mbrojë dhe ruajë pronën e shoqërisë, përfshirë këtu edhe dokumentacionin zyrtar.
 - k-** Të mos të përdorë ose të lejojë që të përdoret prona e shoqërisë për asnjë qellim tjetër, përveçse për kryerjen e veprimtarive të miratuara, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - l-** Të mos bëjë dhe të mos bëhet pre e provokimeve, ngacmimeve të të gjitha formave nga punonjësit, qytetarët apo persona të tjerë për shkak të punës, për qëllime që bien në kundërshtim me këtë Kod, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - m-** Të kujdeset për pasurinë e institucionit dhe të mos e përdorë atë për përfitime personale.
 - n-** Të trajtojë në mënyrë të barabartë vartësit, kolegët dhe gjithë qytetarët që kërkojnë një shërbim prej tij.
 - o-** Të mos konsumojë pije alkoolike apo duhan në ambjentet e institucionit.
 - p-** Kur është rasti të ruajë konfidencialitetin e informacionit, që ka në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8503, datë 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".
 - q-** Pas largimit nga detyra nuk duhet të përdorë informacionin konfidencial, të marre gjatë kryerjes së detyrës, për interes personal.
 - r-** Për një periudhë kohe 2-vjeçare, pas largimit nga detyra, ish-punonjësi nuk duhet të përfaqësojë asnjë person ose organizatë në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me shoqërinë, për detyrën që ai ka kryer ose në vazhdimësi të saj.

Neni 4

Njohja dhe zbatimi

1. Sektori i shërbimeve të brendshme është i detyruar t'i bejë të ditur të gjithë punonjësve aktualë apo punonjësve të rinj (në çastin e punësimit të tij) të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ky kod dhe aktet e tjera ligjore në fuqi dhe që duhen respektuar nga punonjësit.



2. Të gjithë punonjësit kanë për detyrë të sillen në përputhje me këtë kod, ligjet dhe aktet e tjera nëligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë dhe nga ana tjetër ata kanë të drejtë të informohen për çdo ndryshim ose shtesë në të ardhmen.
- 3 Të gjithë punonjësit duhet të kërkojnë këshillim nga Sektori i shërbimeve të brendshme dhe zyra juridike për çdo paqartësi që mund të ketë në lidhje me zbatimin e këtij kodi dhe aktet nëligjore në fuqi.
4. Dispozitat e këtij kodi dhe akteve të tjera nëligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë, janë pjesë e kushteve të punësimit për çdo punonjës. Shkelja e tyre behet shkak për marrjen e masave disiplinore.
5. Kryetarët/shefat e degëve/sectorëve si dhe drejtoria e shoqërisë kanë detyrimin dhe përgjegjësinë për të kontrolluar zbatimin e rregullave të treguara në këtë kod si dhe aktet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë dhe të propozojnë ose të marrën masat e duhura disiplinore për shkeljet e tij.

Neni 5

Masat disiplinore

Çdo punonjës i shoqërisë që shkel parimet e etikes të përcaktuara në këtë Kod si dhe aktet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë kur veprimet e tyre nuk përbejnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore, sipas procedurës dhe hierarkisë së përcaktuar në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës, si dhe rregulloren e brendshme të shoqërisë.

Në varësi të llojit të shkeljes, masave të mëparshme dhe kushteve konkrete që kryhet çdo lloj shkelje nga punonjësit, me propozim të kryetarëve/shefave të degëve/sectorëve mund të jepen masat disiplinore të mëposhtme :

- 1- Vërejtje (tërheqje vëmendje).
- 2- Vërejtje me shkrim.
- 3- Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna.
- 4- Largim nga puna.

Mënyra e konstatimit/propozimit të marrjes dhe më pas të njoftimit të masave disiplinore do të jetë e njëjtë me atë të përcaktuar në aktet e tjera ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë.

Neni 6

Baza ligjore

Ky Kod u hartua bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Statutit dhe Aktit të Themelimit të shoqërisë; Ligjit Nr.9131 datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"; Ligjit Nr. 7961 dt 12.07.1995 " Kodi i Punës së RSH " i ndryshuar; Rregullores së Brendshme të "Porti Detar" Vlorë sh.a si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me fushën e veprimit të këtij kodi.

Neni 7

Dispozita përfundimtare

Kodi i Etikës hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit prej gjithë punonjësve të "Portit Detar" Vlorë sh.a. dhe miratimit nga drejtoria e shoqërisë.

